



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 16.04.2025
Numër Protokolli: 2798/2025

A.nr.1801/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare; Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1801/2024, të datës 03.12.2024, të parashtruar nga ankuesi I.K., kundër organit të punësimit Zyra e Kryeministrit -Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1801/2024, e datës 03.12.2024, e parashtruar nga ankuesi, I.K.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 26.11.2024, i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, lidhur me përfundimin e procedurës të pranimit sipas Konkursit me numër reference RN00015225.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në Shërbim Civil, I.K.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 03.12.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me vlerësimin e procedurës së pranimit sipas Konkursit me numër reference RN00015225, pozita e punës “*Zyrtar i Lartë për Digjitalizimi dhe bashkëpunim ndërdisiplinor mes departamenti të IHKKL*”, në Zyrën e Kryeministrit-Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovës ndërsa, kjo e fundit, më datë 18.12.2024, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në tekstin e mëtejshëm referuar: (*Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me Nr.Protokolli 6419; Kopjen e letërnjoftimit me nr.750036; Njoftimin e datës 26.11.2024; Përgjigjen në ankese të datës 18.12.2024; Kopjen e konkursit me Nr. Ref. RN00015225 të datës 20.9.2024; Listën e aplikativë; Njoftimin e datës 31.10.2024 për listën e kandidateve të aprovuar; Vendimin e datës 07.11.2024 për themelimin Komisionit të pranimit; Akt Emërimit të datës 01.07.2024; Vendimin e datës 01.08.2024; Vendimin e datës 01.07.2024; Akt Emërimit të datës 01.08.2024; Akt Emërimit të datës 01.08.2024; Aplikacionin e ankuesit I.K te datës 27.09.2024 të bashkangjitur me dokumentet përcjellëse te aplikimit; Njoftimin e datës 19.11.2024; Formularët e vlerësimit të intervistë me gojë për kandidatin I.K; Listën e renditjes përfundimtarë te kandidateve e datës 26.11.2024; Emalin e datës 21.11.2024 nga SH.H ; Kopjen e testit me shkrim të ankuesit;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se **ankesa është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës ka gjetur se Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, më datë 20.09.2024, ka shpallur konkursin publik për grupin “*Grupin i teknologjisë informative*”, respektivisht, për pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë për Digjitalizim dhe bashkëpunim ndërdisiplinor mes departamenteve të IHKKL*”, me numër të referencës RN00015225, klasa profesional 1, ku afati për aplikim ishte nga data 21.09.2024 deri më 20.10.2024.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 14 kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar vetëm 4 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi i cili si kandidat i vetëm me kalueshmëri të pragut nga faza e vlerësimit të testit me shkrim, dhe atë me 51 pikë të arritura, i është nënshtruar vlerësimit të intervistës me gojë, ku nga Njoftimi mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve rezulton se i njëjti nga vlerësimi i intervistës me gojë ka arritur 16.2 pikë, rrjedhimisht sipas këtij akti i njëjti në këtë procedurë rekrutimi ka arritur gjithsejtë 67.2 pikë të përgjithshme.

Organi i punësimit me datë 26.11.2024, ka publikuar Njoftimin për përfundimin e procedurës së pranimit lidhur me pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë për Digjitalizim dhe bashkëpunim ndërdisiplinor mes departamenteve të IHKKL*”, për shkak së asnjë kandidat nuk ka kaluar pragun prej 70% të pikëve të përgjithshme të vlerësimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vlerësimi i eses me pikë minimale është realizuar nga Komisioni i Pranimit i cili nuk është i fushës përkatëse, duke theksuar ndër të tjera se vlerësimi i CV-së nuk është real pasi që posedon certifikata profesionale, diplomë të fakultetit dhe përvojën e punës si dhe po ashtu se komisioni sa i përket intervistës e ka vlerësuar me minimumin e pikëve të mundshme, për çka propozon që Komisioni i IKKL-së të rishikoj vlerësimin e tij, si për ese ashtu edhe për vlerësimin e CV-së dhe intervistës me gojë.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore iu referuar dispozitave të nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: 1.*Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.* 2. *Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së.* 3.

Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përfshihet përcaktimi i këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”.

Po ashtu Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë: Neni 8 [Vlerësimi profesional]: Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj. Neni 9: [Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim]: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNj. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. Neni 10 [Vlerësimi nëpërmjet intervistës] 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë

kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimi mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve.

Referuar kuadrit ligjor si dhe mbështetur në mandatin kushtues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, Kolegji i Këshillit ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë procedurën përkatëse të rekrutimit, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së pretendimi ankimor i ankuesit se në testin me shkrim nuk është vlerësuar drejtë ne ese sepse është vlerësuar minimalisht, nuk qëndronë dhe si e tillë është i pa bazuar, ngase, Kolegji i Këshillit nga analizimi i testit me shkrim për pozitën përkatëse të punës, konstaton se testi ka përmbajtur 25 pyetje me zgjidhje të shumëfishta dhe një ese me shkrim, gjithë kjo në pajtueshmëri me nenin 9 paragrafi 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe së bazuar në përgjigjet e dhëna nga ankuesja e njëjta ka arritur gjithsej **44 pikë**, tek pyetjet me zgjidhje të shumëfishta, ndërsa, në ese është vlerësuar me 7 pike nga 20 pikë maksimale, duke grumbulluar gjithsej 51 pikë, si pikë të mjaftueshme për të vazhduar me fazën e intervistës me gojë ashtu siç parashihet me nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: *2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë*

Rrjedhimisht, duke qenë se ankuesi ka arritur pikët e mjaftueshme për kalueshmëri nga testi me shkrim, në fazën e vlerësimit përfundimtar apo intervistën me gojë ka marrë pjesë vetëm ankuesi nga katër kandidatët e listës së ngushtë, dhe se i njëjti nga anëtarët e Komisionit të pranimi është vlerësuar ne totalin prej 16.2 pikë, ndërsa lidhur me pretendimet e tij se vlerësimi i CV-së nuk është real pasi që posedon certifikata profesionale, diplomë të fakultetit dhe përvojën e punës, Kolegji i Këshillit, nga analizimi i formularëve të vlerësimit të datës 25.11.2024, ka gjetur se i njëjti është vlerësuar me pike maksimale tek fusha e Jetëshkrimit (CV) Arsimi, Përvoja e punës dhe Trajnimet, andaj edhe pretendimet e ankuesit se Komisioni i Pranimi nuk ka vlerësuar meritorisht apo minimalisht të njëjtin janë të pa qëndrueshme sikurse edhe pretendimi se Komisioni nuk është i fushës përkatëse është i pa bazuar, ngase Komisioni i themeluar sipas Vendimit me numër protokoli 01/214 të datës 08.11.2024 të Drejtorit Ekzekutiv të IKKL-së, gjegjësisht përbërja e anëtarëve të cilët kanë marrë pjesë në vlerësimin profesional të kandidatëve në këtë procedurë rekrutimi, sipas shkresave të lëndës rezulton se ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara nga paragrafi 1 dhe 2 të nenit 40 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, duke qenë se ankuesi si kandidat i vetëm që ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit, ka arritur gjithsejtë 67.2 nga kjo procedurë rekrutimi, dhe duke qenë se nuk është konstatuar shkelje procedurale dhe materiale në vlerësimin e Kolegjit organi i punësimit në këtë rast Instituti për Krime

të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, me rastin e përfundimit të procedurës së pranimi me numër reference RN00015225, për shkak se as njeri nga kandidatet nuk e ka kaluar pragun prej 70 % të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Thënë si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1801/2024

Ylber Fetahaj

Malsore Gashi Bajraktari

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit I.K.;
- Udhëheqëses së Personelit në Institutin e Krimeve të Kryera Gjate Luftës në Kosovë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.